

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“URA Telecoms “ shpk

Në Tiranë, sot më datë 10.11.2023, i poshtëshënuari:

- 1- Diljan Saggar, i datëlindjes 14.11.1964, lindur në Hillingdon shtetas anglez dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte , me numër personal 518100888,

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “URA Telecoms “ shpk,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin ‘URA Telecoms’, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rruga "Vilave", Sunrise Residence, prane TEG nr.15 , Lunder, Tiranë

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:
Blerje dhe shitje te minutave , mesazheve dhe celulareve ne fushën e telekomunikacionit etj

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6



Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në një kuote, e cila zotërohet si më poshtë:

Diljan Saggar, zotëron 1 kuotë me vlerë 100.000 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë i shoqërisë është:

- 1- Diljan Saggari, i datëlindjes 14.11.1964, lindur në Hillingdon shtetas anglez dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaportë , me numër personal 518100888, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripëritëje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "URA Telecoms" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Diljan Saggari

10/11/2023

